



7 MAJ

BUXHETET E KOMUNAVE VERIORE TË KOSOVËS: MARRËVESHJE MË NË FUND

Data e 4 majit shënon fundin e mosmarrëveshjeve në mes të katër komunave veriore me shumicë serbe dhe Qeverisë së Kosovë në lidhje me miratimin e buxheteve komunale të Zveçanit, Zubin Potokut, Leposaviqit, dhe Mitrovicës së Veriut. Mosmarrëveshjet filluan më 28 shkurt, pasi komunat dhe qeveria qendrore nuk arritën të pajtohen për shumën e saktë të buxheteve që duhet t'i alokoheshin komunave veriore si pjesë e buxhetit të Kosovës për vitin 2015. Fillimisht, të katër komunat kishin kërkuar buxhet që Ministria e Financave i kishte vlerësuar të ishin shumë më të lartë se që do të ishte e arsyeshme bazuar në numrin e banorëve të tyre. Për më tepër, shumata e kërkuara ishin shumë më të larta se ato që i janë alokuar komunave tjera në Kosovë me numër të ngjashëm të banorëve. Dallimi mes asaj që ishte kërkuar dhe asaj që ishte miratuar nga qeveria ishte tejet i madh: Zveçani kishte planifikuar buxhet prej €14 milionë eurosh, ndërsa qeveria i kishte alokuar €1.6 milion euro; Zubin Potoku kishte planifikuar buxhet prej €21.5 milionë eurosh, ndërsa qeveria i kishte alokuar €1.8 milion; Leposaviqi kishte miratuar buxhet prej €11.5 milionë eurosh, ndërsa qeveria i kishte alokuar €2.3 milionë; Mitrovica e Veriut kishte kërkuar buxhet prej €20 milionë eurosh, ndërsa qeveria qendrore i kishte alokuar buxhet prej €2.7 milionë eurosh komunës.¹ Për shkak të mospërputhjeve së madhe mes buxheteve të kërkuara nga ana e komunave dhe atyre të miratuara nga niveli qendror, Qeveria e Kosovës kërkoi nga komunat që të hartojnë buxhete të reja që janë në pajtim me qarkoret buxhetore të caktuara nga Qeveria më herët.² Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut, Goran Rakiq, deklaroi se mospërputhjet mes buxheteve mund të shpjegohen pjesërisht me shifrat e ndryshme të popullsisë në veri me të cilat disponojnë autoritetet komunale dhe ato qendrore.³ Sipas Rakiqit, qeveria qendrore ka gjetur se komuna e tij i ka 12,000 banorë, por në zgjedhjet e fundit komunale ku 28,000 qytetarë votuan tregojnë se numri i sakte i banorëve mundet të jetë shumë më i lartë.⁴ Mospërputhshmëria e numrave të popullsisë së komunës buron nga fakti që qeveria bazohet për numrin e popullsisë në regjistrimin e vitit 2011.⁵ Për më shumë të dhëna në lidhje me regjistrimin e popullsisë së vitit 2011 dhe të dhënat për të gjitha komunitetet, ju lutem referohuni [analizës](#) sonë.

Rakiq gjithashtu nënvizoi se Mitrovica e Veriut është komuna e vetme në Kosovë që nuk ka ndërtesë të veten komunale, fakt që duhet të merret parasysh kur hartohet buxheti.⁶

¹ <http://www.balkaninsight.com/en/article/prishtina-blocks-the-accounts-of-serb-municipalities>

² <http://www.balkaninsight.com/en/article/prishtina-blocks-the-accounts-of-serb-municipalities>

³ <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1705529/Raki%C4%87%3A+Mali+bud%C5%BEet+za+Severnu+Mitrovicu.html>

⁴ <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1705529/Raki%C4%87%3A+Mali+bud%C5%BEet+za+Severnu+Mitrovicu.html>

⁵ <http://www.ecmikosovo.org/?p=3504>

⁶ <http://www.radiokim.net/vesti/politika/rakic-budzet-za-severnu-mitrovicu-nedovoljan.html>

Një mospajtim tjetër ishte edhe mospërfshirja e personelit shëndetësor dhe atij arsimor komunal në buxhetet e para të hartuara nga autoritetet komunale veriore; Ministria e Financave kërkoi nga komunat që në buxhet të përfshiheshin të gjithë shërbyesit publik të cilët paguheshin nga buxheti publik— duke përfshirë këtu edhe ata shërbyes civil që janë të angazhuar në sektorin e shëndetësisë dhe atij të arsimit, që momentalisht financohen nga Republika e Serbisë. Personeli që punon në sektorin shëndetësor dhe atë të arsimit në veri të Kosovës vazhdon të paguhet nga Republika e Serbisë. Në anën tjetër, Edita Tahiri, Ministër për Dialog, tha se “funktionaliteti i strukturave legale në veri të Kosovës pengohet nga përzjerja e Serbisë” dhe se linjat buxhetore duhet të jenë në përputhje të plotë me standardet e Kosovës.⁷

Përfaqësuesit e komunave veriore, në anën tjetër, zgjodhën që të mos i përfshijnë rrogat e zyrtarëve komunalë që punojnë në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit, sepse kishin pritje se ato rroga do të vazhdonin të paguheshin nga Serbia. Ata argumentuan se financimi i këtyre strukturave nuk duhet të përfshihet në buxhetin e komunave në kuadër të buxhetit të Kosovës derisa të mos rregullohet financimi i tyre nëpërmjet Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe. Kryetarja e Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut, Ksenija Bozhoviq, pohoi se buxhetet komunale të komunave veriore janë hartuar në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit dhe se në të ardhmen ato duhet të hartohen nëpërmjet Asociacionit/Bashkësisë, pas themelimit të këtij Asociacioni/Bashkësie.⁸

Sipas Marrëveshjes së Brukselit, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të ketë vështrim të plotë mbi fushat si zhvillimi ekonomik, arsimit, shëndetësia, zhvillimi urban dhe rural. Megjithatë, Marrëveshja nuk e specifikon nëse Asociacioni do të ketë autoritet të hartojë buxhete komunale,⁹ dhe legjislacioni ekzistues i Kosovës nuk lejon transferimin e kompetencave nga ana e komunave në çfarëdo autoriteti tjetër në fushat e buxhetit dhe financave, duke përfshirë këtu edhe Asociacionin e ardhshëm të Komunave.¹⁰ Për më shumë në lidhje me këtë tematikë, luteni të i referoheni [analizës](#) sonë të fundit mbi kompetencat dhe fushëveprimin e mundshëm të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe sipas legjislacionit të Kosovës në fuqi.

Pas bisedimeve të stërzgjatura dhe raundit të ri të takimeve në kuadër të procesit të dialogut në Bruksel, buxhetet komunale u ndryshuan në atë mënyrë që të jenë në përputhje me kornizën ligjore dhe në pajtueshmëri me qarkoret buxhetore të caktuara nga Qeveria e Kosovës. Mbetet e paqartë nëse zyrtarët komunalë të këtyre komunave do të paguheshin vetëm nga buxhetet komunale të aprovuara nga Kosova, apo se a do të vazhdojnë të financohen nga Serbia pa pëlqimin e Kosovës.

ECMI Kosova lavdëron konsensusin e arritur për buxhetet komunale që i dha fund bllokimit financiar dy-mujor, dhe inkurajon qeveritë lokale dhe atë qendrore që të vazhdojnë të punojnë bashkërisht dhe në mënyrë efektive që të sigurojnë se të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë dhe se përfitojnë fonde publike të përshtatshme. Çështja e integritetit të shërbimit shëndetësor dhe të atij të arsimit në veri në kornizën ligjore të Kosovës mbetet e pazgjidhur dhe kërkon implementimin e plotë të dispozitave të Marrëveshjes së Brukselit, duke përfshirë ato dispozita që kanë të bëjnë me Asociacionin.

Dhe në fund, Qeveria e Kosovës duhet të konsiderojë adaptimin apo revidimin e rezultateve të regjistrimit të popullsisë për komunitetin serb, duke marrë parasysh hapat e rëndësishëm të ndërmarrë për integrimin e këtij komuniteti në shoqërinë kosovare që nga viti 2011 kur është bërë regjistrimi për herë të fundit në Kosovë.

⁷<http://www.dw.de/komunat-e-veriut-te-kosoves-refuzojne-buxhetin-e-prishtines/a-18287041>

⁸<http://illyriapress.com/bllokohen-xhirollogarite-e-komunave-me-shumice-serbe-ne-veri/>

⁹<http://mm.primedb.net/projects/new-perspektiva/alb/?PostID=77>

¹⁰<http://www.ecmikosovo.org/?p=6247>

NGJARJET E FUNDIT POLITIKE

Për më shumë informata ju lutem na kontaktoni në + 381 (0) 38 224 473 ose përmes postës elektronike në info@ecmikosovo.org

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komunitetevminoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe tëndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhepërkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhengrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhebashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.